



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KLOS  
KRYETARI

Nr. 2100 Prot.

Klos, më 11/08/2021

V E N D I M

Nr. 61, datë 11/08. 2021

PËR

“HEQJEN E PALIGJSHME TË TUBAVE NË KANALIN VADITËS NË FSHATIN  
PATIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE KLOS”

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, Ligjin Nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, bazuar në ankesat e banorëve si dhe vendimi që ka marrë kryesia e fshatit Patin në lidhje me këtë problematik,

V E N D O S A :

1. Të hiqen menjëherë tubat e paligjshme të ujit në kanal in vaditës në fshatin Patin, për arsyen se këto ndërhyrje janë në kundërshtim me ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, bazuar në ankesat e banorëve të fshatit Patin si dhe vendimi që ka marrë kryesia e këtij fshati.
2. Për çdo ndërhyrje të paligjshme, pas zbatimit të këtij vendimi, do zbatohen masat administrative ligjore, (gjobë) sipas legjislacionit përkatës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat përkatëse, **Sektori i Ujitjes dhe Kullimit, Policia Bashkiake, Njësia Administrative Klos dhe Kryesia e Fshatit Patin.**
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilmi Hoxha



Konceptoi: A. Greçi  
Pranoi: Sh. Bala  
Konfirmoi: B. Dedolli  
Miratoi: F. Mira  
Datë. 11.08.2021.  
Kopje Nr. 4 (katër).